



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

Vendim

Nr. 6 datë 22 / 09 /2017

**“ Për Miratimin e “Lejes për përdorim uji teknologjik”,
Subjekti “Kovaçi-03”sh.p.k”**

Në mbështetje të neneve 7 pika 2 , nenit 50, 51 dhe nenit 52 të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujore”, si dhe kërkesës së subjektit “Kovaçi-03” Sh.p.k, me propozim te A.B.U. Mat;

Këshilli i Basenit Ujor Mat;

V e n d o s i:

1.Miratimin e “Lejes për përdorim uji teknologjik”, Pus shpimi ekzistues sipas studimit të paraqitur nga subjekti “Kovaçi-03” shpk me administrator z. Aleks Gjini, me këto të dhëna:

-Vendndodhja e pus-shpimit, Tresh, Zejmen, Lezhë

-Prurja mesatare : 4 l/s

-Sasia e ujit për përdorim: 0.3 l/s

-Koordinatat e burimit ujor:

| Kordinatat | | Thellësia |
|------------|-----------|-----------|
| X | Y | |
| 46 20 296 | 43 89 760 | 15 |

2. Ngarkohet A.B.U. Mat për zbatimin e këtij vendimi .

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËSI I A.B.U. MAT

Ast NIKOLLA



KRYETARI I K.B.U. MAT

Eduard NDRECA

